



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUSHAJ
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1
Tirane
TEL: 0692097547

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.A.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 3788

Nr. koleksioni: 1563

Tirane më 11/08/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 13 fletë



A2025053540147588541



A2025053540147588541

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQERISE AKSIONARE
“ STAR GROUP ENERGY” SHA**

Sot, më datë 11/08 /2025 (dymijë e njëzet e pesë), përpara meje Zv.Notere Ina Papa, në bazë të autorizimit me Nr.20 Prot., datë 08.08.2025 dhe në bazë të urdherit të emërimit me Nr.3950/1Prot., datë 16.06.2023 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, me zyrë në adresën Tiranë, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tiranë, u paraqitën personalisht:

1. **ERDOĞAN HACIOĞLU** i biri i Erdem, i dtl. 17/08/1976, lindur në Stamboll dhe banues në Mugla, Turqi shtetas Turk, madhor, me zotesi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet dokumentit Pasaporte Turke me nr. U24329519.
2. **BEKIR METIN DEMIRSU**, i biri i Mehmet Salahattin, i dtl. 15/01/1963, lindur në Yenibosna, Stamboll dhe banues në Antalia, Turqi shtetas Turk, madhor, me zotesi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet dokumentit Pasaporte Turke me nr. U22974199.
3. **RAŞİT GÜLERYÜZ**, i biri i Avdi, i dtl. 02/08/1970, lindur në Stamboll dhe banues në Antalia, Turqi, shtetas Turk, madhor, me zotesi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet dokumentit Pasaporte Turke me nr. U23007570.

të cilët më kërkuan redaktimin e këtij akti themelimi dhe statuti, të shoqerisë AKSIONARE, me oferte private, me emertimin “ STAR GROUP ENERGY” SH.A, (më poshtë e quajtur “Shoqeria”), në përputhje me ligji nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

FORMA LIGJORE

1. Shoqëria është një shoqëri aksionare me ofertë private.
2. Shoqëria vepron në përputhje me këtë akt-themelimi dhe statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.
3. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me parashikimet e nenit 228 dhe vijues të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

KREU I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

NENI 1

KRIJIMI

Shoqeria është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri Aksionare me Oferte Private” (më poshtë e quajtur “Shoqeria”).



A2025053540147588541

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë se saj, në fushat e mëposhteme :

- tregtimit me shumicë dhe pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.
- tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, përfshin tri llojet e veprimtarive- Lloji “A”: tregtimi me shumicë i naftës bruto e nënprodukteve të saj të kategorive 0, II, III, IV e V, b) Lloji “B”: tregtimi me shumicë i gazit të lëngshëm të naftës, kategoria I, përfshirë edhe mbushjen e bombolave me këtë nënprodukt; c) Lloji “C”: tregtimi me shumicë i karburanteve, kategoritë II/B e III/C, për mjetet e fluturimit.
- përpunimin, transportimin dhe tregtim të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.
- tregtim me shumë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve edhe elektrike, import-export i tyre.
- dhënie me qira e automjeteve të cdo lloji.
- çdo punë tjetër që konsiderohet e dobishme dhe e nevojshme për shoqërinë në të ardhmen dhe e lejuar me ligj.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Akt -Themelim dhe Statut.

NENI 3

REGJIMI JURIDIK

3.1. Shoqëria është shoqëri aksionare. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit dhe Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

3.2. Me vendim të saj, Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme do të përshtatë Aktin e Themelimit dhe Statutin të shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

NENI 4

EMËRTIMI DHE SELIA JURIDIKE E SHOQËRISË

4.1. Asambleja e Aksionareve vendosi që shoqërinë t’a emërtojë: **“STAR GROUP ENERGY”**
SH.A



A2025053540147588541

4.2 Shoqëria do t'a ketë selinë në qytetin e Tiranës, Rruga " Mujo Ulqinaku" Nr.51.

4.3 Shoqëria mund të hapë edhe zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje të parashikuar nga ligji në shoqëri të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

4.4 Shoqëria mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.5 Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendrën e vet.

4.6 Shoqëria ka vulën e saj dhe logon e saj. Forma dhe përmbajtja e vulës mund të ndryshohen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, vula e shoqërisë dhe logoja mund t'i raportohen Qendrës Kombëtare të Biznesit.

4.7 Shoqëria tregtare "**STAR GROUP ENERGY**" SH.A me regjistrimin e këtij akt-themelimi dhe statuti pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pas regjistrimit të saj si person juridik, mund të marrë masa për të patur një adresë interneti si dhe një postë elektronike për komunikim. Këto adresa do të jenë të vlefshme për të tretët vetëm pasi t'i jenë njoftuar Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me pikën 2 të nenit 69 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA

NENI 5

TË DREJTAT E SHOQËRISË DHE TË AKSIONAREVE

5.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

5.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

5.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë/akionare në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

5.4. Me fitimin e personalitetit juridik Shoqëria bëhet përgjegjëse kundrejt palëve të treta për detyrimet dhe dëmet që shkakton gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj.

Aksionarët e shoqërisë do të jenë përgjegjës kundrejt palëve të treta deri në shumën e kontributit të derdhur në kapitalin aksionar.

5.5. Aksionarët kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.



A2025053540147588541

5.6. Aksionarët kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogarite ekonomike etj.

NENI 6 KOHEZGJATJA

6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar, pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

6.2 Ky afat mund të ndryshohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të Akt-Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

KREU III KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

NENI 7 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 10.000.000 Lekë shqiptare dhe është i ndarë në 1.000 aksione me vlerë nominale 10.000 Lekë shqiptare secili. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar nga aksionerët e shoqërisë:

- Aksioneri, ERDOĞAN HACIOĞLU 500 aksione, me vlerë nominale 500.000 lekë secila, me vlerë të përgjithshme 5,000,000 Lekë, të cilat përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë.
- Aksioneri, BEKIR METIN DEMIRSU, 300 aksione, me vlerë nominale 300.000 lekë secila, me vlerë të përgjithshme 3,000,000 Lekë, të cilat përfaqësojnë 30 % të kapitalit të shoqërisë.
- Aksioneri, RAŞİT GÜLERYÜZ, 200 aksione, me vlerë nominale 200.000 lekë secila, me vlerë të përgjithshme 2,000,000 Lekë, të cilat përfaqësojnë 20 % të kapitalit të shoqërisë.

Aksionet janë tërësisht nominale dhe janë lirisht të transferueshme ndërmjet aksionerve të shoqërisë, sipas ligjit shqiptar në fuqi ;

Aksionerët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretëve vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara.

Çdo aksion i jep të drejtën e një vote titullarit të tij;

Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo të holla siç parashikohet në ligj.

Secili aksionar do të shlyej vlerën prej $\frac{1}{4}$ në formë parapagimi menjëherë me nënshkrimin e këtij akt-themelimi dhe statuti dhe pjesa e mbetur prej $\frac{3}{4}$ do të likujdohet menjëherë pas regjistrimit dhe hapjes së llogarive bankare të shoqërisë aksionare.

Erdoğan Hacıoğlu
Bekir Metin Demirsu
Raşit Güler

[Signature]

[Signature]

[Signature]



A2025053540147588541

- Aksioneri, **ERDOĞAN HACIOĞLU** do të shlyej vlerën prej 1,250,000 lekë në formë parapagimi dhe pjesa e mbetur do të shlyhet menjëherë pas themelimit dhe hapjes së llogarisë bankare.
- Aksioneri, **BEKIR METIN DEMIRSU** do të shlyej vlerën prej 750,000 leke në formë parapagimi dhe pjesa e mbetur do të shlyhet menjëherë pas themelimit dhe hapjes së llogarisë bankare.
- Aksioneri, **RAŞİT GÜLERYÜZ** do të shlyej vlerën prej 500,000 lekë në formë parapagimi dhe pjesa e mbetur do të shlyhet menjëherë pas themelimit dhe hapjes së llogarisë bankare.

NENI 8 TRANSFERIMI I AKSIONEVE

1. Aksionet e shoqërisë janë lirisht të transferueshme.
2. Aksionet mund t'u transferohen të tretëve nëpërmjet blerjes, trashëgimisë, dhurimit dhe çdo mënyre tjetër të pranuar nga ligji.
3. Transferimi i aksioneve tek të tretët është i kushtëzuar nga e drejta e parablerjes me të njëjtat kushte, e drejtë e cila duhet të ushtrohet brenda 2 (dy) muajsh nga marrja e njoftimit të drejtuar aksionarëve, me postë rekomande, me vërtetim marrje, mbi shitjen e dëshiruar dhe kushtet e paraqitura. Mosrespektimi i kësaj dispozite e bën shitjen të pavlefshme.
4. Çdo transferim i aksioneve duhet të regjistrohet në regjistrin e aksioneve të shoqërisë dhe në Regjistrin Tregtar Shqiptar, në përputhje me nenin 119 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" përndryshe, mbajtësi i aksionit nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në këtë akt-themelim dhe statut dhe ligjin shqiptar.
5. Në rastet e kalimit të aksioneve me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata.
6. Kontrata për kalimin e aksioneve hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshirë këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit të pronësisë.

NENI 9 MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË AKSIONEVE

1. Aksionet e shoqërisë dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë ;
 - b) shitblerjes;
 - c) dhurimit,
 - ç) trashëgimisë
 - d) çdo mënyrë tjetër të parahikuar nga ligji.



A2025053540147588541

2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 10 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

1. Asambleja e Përgjithshme vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit me një shumicë të cilësuar prej 3/4 –tave të të gjithë aksionarëve.
3. Mënyrat dhe procedurat përkatëse të rritjes dhe zvogëlimit të kapitalit do të vendosen dhe kushtëzohen në përputhje me nenet 168-186 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, por gjithmonë duke iu përmbajtur shumicës së cilësuar të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

NENI 11 ANULIMI I AKSIONEVE

Asambleja e Përgjithshme në 3/4 e votave të të gjithë aksionarëve mund të marrë vendimin mbi anulimin e aksioneve qoftë dhe të atyre që zotëron njëri aksionar. Në këtë rast do të ndiqen dispozitat dhe kërkesat e zvogëlimit të kapitalit, duke respektuar veçanërisht dispozitat e nenit 186, paragrafi I tretë.

KREU IV ORGANET E SHOQËRISË

NENI 12 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organet e shoqërisë janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme, në cilësinë e organit vendimmarrës për shoqërinë;
 - b) Këshilli i administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel);
2. Secili nga keto organe do të ushtrojë detyrat e tij sipas akt-themelimit dhe statutit dhe ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 13 ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME NË CILËSINË E ORGANIT VENDIMMARRËS

1. Asambleja e Përgjithshme, është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme ushtron kompetencat e mëposhtme dhe merr vendimet për çështjejt e mëposhtme:



A2025053540147588541

- a. përcaktimin e politikave tregtare;
- b. ndryshime të akt-themelimit dhe statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit;
- d. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të këtij neni ;
- f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- h. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- i. pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- j. ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji që i njihen Asamblesë së Përgjithshme si organ vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Aksionereve, merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Aksionereve, regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe nga ligje të tjera ose nga dispozitat e akt-themelimit dhe statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe, në rastet e parashikuara nga ligji, nga anëtarët e këshillit të administrimit, apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
3. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
4. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



A2025053540147588541

5. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.
7. Dispozita e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e organeve administrative.

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:

- a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
- b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:
 - i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;
 - ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;
 - iii) procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;
 - iv) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 138 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

3. 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:

- a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;
- b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;
- c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme.

4. Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës, që njoftohet sipas nenit 137 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.



A2025053540147588541

2. Nëse asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e akt-themelimit dhe statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

3. Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij neni dhe të nenit 137 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 14

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme dhe rendi i ditës, i kërkuar nga aksionarët e pakicës

1. Aksionerët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në akt-themelim dhe statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare".

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

NENI 15

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

NENI 16

PJESËMARRJA ME MJETE KOMUNIKIMI ELEKTRONIKE



A2025053540147588541

1. Ky akt themelim dhe statut parashikon për aksionarët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

2. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) videokonferencat,
- c) komunikimin e ndërsjellë, i cili u mundëson ortakëve të shprehen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër;
- d) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

3. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar aksionarëve marrjen pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kusht që të merren masat teknike, të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

NENI 17 KUORUMI

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të ligjit "Për Tregetaret dhe Shoqëritë Tregtare", asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të ligjit

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 18 MARRJA E VENDIMEVE

1. Asambleja e përgjithshme vendos për ndryshimin e akt-themelimit dhe statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me tre të katërtat e votave të aksionerëve, ne qoftese ne votim marrin pjesë aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.

NENI 19 TË DREJTAT E VOTËS

- Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.
- Aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote. Në këtë rast, aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.



A2025053540147588541

- Ndalohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre më shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson.

NENI 20

Aksioneri, humbet cilesine e te qenit aksioner ne shoqeri, ne rastet kur :

- deklarohet i falimentuar, apo ne procedura te tjera gjyqesore falimentimi,
- deklarohet pa zotesi te plota juridike dhe per te vepruar,

NENI 21

KESHILLI I ADMINISTRIMIT FUNKSIONI, KOMPETENCAT DHE SHPERBLIMI

Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- c) emeron dhe shkarkon administratorin e shoqërisë;
- d) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- e) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit; të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
- gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
- g) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
- h) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj.

NENI 22

ANËTARËT E KËSHILLIT TE ADMINISTRIMIT



A2025053540147588541

Këshilli Administrimit do të përbehet nga 3 anetare. Anëtarët janë individë.

Këshilli i parë i Administrimit do të ushtrojë kompetencat sipas ligjit dhe ketij akt-themelimi dhe statuti për një periudhë 3 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

1. Anëtarët të Këshillit të Administrimit emërohen:

- **ERDOĞAN HACIOĞLU** i biri i Erdem , i dtl. 17/08/1976, lindur në Stamboll dhe banues ne Mugla, Turqi shtetas Turk, madhor, me zotesi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet dokumentit Pasaporte Turke me nr. U24329519.
- **BEKIR METIN DEMIRSU**, i biri i Mehmet Salahattin, i dtl. 15/01/1963, lindur në Yenibosna, Stamboll dhe banues në Antalia, Turqi shtetas Turk, madhor, me zotesi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet dokumentit Pasaporte Turke me nr. U22974199
- **RAŞİT GÜLERYÜZ**, i biri i Avdi, i dtl. 02/08/1970, lindur në Stamboll dhe banues ne Antalia, Turqi, shtetas Turk, madhor, me zotesi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet dokumentit Pasaporte Turke me nr. U23007570

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Z. **RAŞİT GÜLERYÜZ** emërohet kryetar i Këshillit të Administrimit, ndërsa z. **ERDOĞAN HACIOĞLU** dhe **ERDOĞAN HACIOĞLU**, janë anëtarë të Këshillit të Administrimit. Mandati i Kryetarit përfundon në datën e përfundimit të mandatit të tij si anëtar.

NENI 23

EMERIMI, DHE SHKARKIMI

Anëtarët e këshillit të administrimit emërohen nga Asambleja e Aksionereve te shoqerise, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash

NENI 24

MARRJA E VENDIMEVE

Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

Mbledhjet e Keshillit të Administrimit mund të merren sipas përcaktimeve ne kete akt themelim dhe statut apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me video konferenca, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.

NENI 25

RREGULLORET, KRYETARI DHE KOMITETET E POSAÇME



A2025053540147588541

Këshilli i Administrimit mund t'i zhvillojë mbledhjet në Shqipëri dhe në vendin e përcaktuar rast pas rasti nga vetë Këshilli i Administrimit. Në qoftë se vendi i mbledhjes nuk është caktuar, atëherë ky vend do të jetë selia e shoqërisë.

1. Akt-Themelimi dhe Statuti ose këshilli i administrimit mund të përcaktojnë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e këshillit të administrimit për këto rregullore merren në mënyrë unanime.

2. Këshilli i administrimit duhet ta zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij, në përputhje me dispozitat e akt-themelimit dhe statutit. Nënkyetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht. Një administrator nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit të administrimit.

3. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

4. Këshilli i administrimit mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.

NENI 26

SHPËRBLIMI

1. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë. Paga e administratorëve mund të shtohet me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga këshilli i administrimit dhe miratohet nga asambleja e përgjithshme.

2. Në përputhje me skemën e përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe me gjendjen financiare të shoqërisë, shpërblimet individuale përcaktohen nga këshilli i administrimit dhe duhet të pasqyrojnë, në mënyrë të përshtatshme, ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve, që mbajnë detyrën e administratorëve dhe anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin, në masën e përshtatshme, të shpërblimeve, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Skema e shpërblimeve, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, shpërblimet individuale, që u jepen administratorëve e anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë, së bashku me një raport për efektin vjetor të këtyre skemave mbi pasurinë e shoqërisë, publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore, sipas shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 154 ligjit "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 27

ADMINISTRATORI

Funksionet dhe Kompetencat

Administrator i shoqërisë mund të jetë edhe një person që nuk është aksioner i shoqërisë.

Administratori, administron dhe drejton pasuritë dhe aktivitetin e Shoqërisë dhe përfaqëson ligjerisht shoqërinë.



A2025053540147588341

Asambleja e Përgjithëshme, ka vendosur që të emërojë si administratorë të parë z. **Eris Zelka, I datëlindjes 04.03.1986, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me Nr.Personal: I60304065K**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie, me një mandat 3 (tre) vjeçar, mandat i cili fillon në datën 12.08.2025.

Administratori ka të drejtën e rizgjedhjes.

Emërimi dhe Kohezgjatja e Mandatit

Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Keshilli i Administrimit me shumicën e votave të anetarëve, që marrin pjesë në mbledhje, pas plotesimit të quorumit të kerkuar nga ligji.

Administratori i shoqërisë mund të rizgjidhet. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin.

2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.

3. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet, si me poshte:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- e) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.

5. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të ligjit 9901 date 14.04.2008, administratori duhet të informoj menjëherë kryetarin e këshillit të administrimit.

7. Asambleja e Aksionereve mund t'e shkarkojë administratorin në çdo kohë.



A2025053540147588541

NENI 28 NDALIMI, KONFLIKTI I INTERESIT

Personat, që janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në kreun III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 vjet nga data e këtij dënimi, nuk mund të mbajnë funksionet e përfaqësuesit ligjor të një shoqërie tregtare, nuk mund të jenë anëtarë të këshillit të administrimit dhe as përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

NENI 29 NDALIMI I KONKURRENCËS

Aksioneret, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërise, përjashtohet nga shoqëria në rast se ushtrojnë për llogari të tij apo të të tregëve aktivitete konkurrence me aktivitetin e shoqërise.

Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në paragrafin e mesiperm, shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

NENI 30 EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR (AUDITUESI LIGJOR)

Asambleja e Aksionereve emeron një ose disa eksperte kontabël të autorizuar (Auditues Ligjor).

Ekspertët Kontabël të Regjistruar (Audituesit Ligjorë) kanë të drejtën e riemërimit. Ekspertë Kontabël i Regjistruar (Auditues Ligjorë) të Shoqërisë, për një afat 3 –vjeçar, me të drejtë riemërimi, caktohen:

- **Eduart Luan Shehu** me nr. license 436 dt 04.12.2019, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ekspert kontabel i autorizuar , mbajtes i licences me nr. 436, lëshuar më datë 04.12.2019.
- **Elvira Petraq Hoxha** me nr. license 193 dt 29.12.2008, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ekspert kontabel i autorizuar, mbajtes i licences me nr. 193, lëshuar më datë 29.12.2008.

NENI 31 VITI FINANCIAR

Viti Financiar



A2025053540147588541

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 32

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve miraton bilancin e pergatitur nga Drejtoria dhe te paraqitur nga Keshilli i Administrimit. Mbledhja e Jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve, vendos rreth shperndarjes se dividendeve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, si parashikohet nga ligji, ne raport me aksionet e zoteruara nga secili prej Aksionareve.

NENI 33

SHPERNDARJA E DIVIDENDIT

1. Dividendi eshte pjesa qe i takon secilit aksionar nga vlere e fitimeve vjetore, e cila vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

2. Fitimet vjetore llogariten ne perputhje me parimet e percaktuara nga ligji nr. 9228, date 29.4.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

3. Me perjashtim te rasteve kur akt-themelimi dhe statuti parashikon ndryshe, dividendi shperndahet mes aksionarëve, ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe aksionet e secilit aksionar perfaqesojne.

4. Ne perputhje me parimet e percaktuara ne nenin 14 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Asambleja e pergjithshme mund te vendose qe shoqeria te mos shperndaje dividendë ose qe fitimi vjetor te mos u paguhet aksionarëve, qe zoterojne aksione te kategorive te vecanta, por keto shuma te perdoren per qelime te tjera. Te drejtat e aksionarëve, sipas parashikimeve te statutit, mund te ndryshohen vetem nepermjet nje vendimi te marrë me tre te katertat e votave, sipas percaktimit te nenit 145 ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 34

PRISHJA E SHOQERISE

1. Shoqeria do te priset:

- a) Me vendim te Asamblesë së Pergjithshme;
- b) Me fillimin e procedurave te falimentimit/likuidimit;
- c) Me vendim te gjykatës kompetente;
- d) Ne çdo rast tjetër dhe sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 35

SHKRIRJA DHE LIKUIDIMI



A2025053540147588541

1. Likuidimi i Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Aksionerëve, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërisë dhe vënien e saj nën likuidim.
3. Për këtë qëllim, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblese së Aksionereve, do të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato që janë parashikimet e ligjit.
4. Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Aksionereve, emeron një ose më tepër likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen procedurave të likuidimit.

NENI 36

LIGJI I ZBATUESHËM

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt-Themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare, ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 37

MOSMARREVESHJET

Çdo mosmarrveshje, konflikt ose pretendim që është parashikuar ose jo me këtë marrëveshje, çdo shkelje, ose pavlefshmeri, do të zgjidhet, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

Ky akt-themelim dhe statut mund të shtohet, ndryshohet ose të zëvendësohet me një Akt-Themelim dhe Statut të ri vetëm me vendim të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblese së Aksionereve

NENI 38

Ky Akt- Themelimi dhe Statut përpilohet në 5(pesë) kopje origjinale ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe në prani të përkthyesit të gjuhës turke Spartak Kadiu, i datëlindjes 18.12.1980 dhe Nr.Personal: I01218087P, dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga aksionerët e shoqërisë, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale, autenticiteti i të cilave vërtetohet nga une Zv.Noterja.

Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë;



A2025053540147588541

Ky Akt-Themelim dhe Statut hyn në fuqi, pas regjistrimit të tij së bashku me Vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për miratimin e tij, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Nënshkruar sot, më 11 / 08 /2025

AKSIONERET:

ERDOĞAN HACIOĞLU

ERDOĞAN HACIOĞLU

BEKİR METİN DEMİRSU

Bekir Metin Demirsu

RAŞİT GÜLERYÜZ

Rasit Guleryuz

ZV. NOTERE

INA PAPA

INA PAPA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANE
NOTERE MIMOZA SADUSHAJ

Adresa: Rr. "Vaso Pasha", Pallati 13/1

tel 042266242

Nr. 20 Prot

Tiranë, më 08.08.2025

AUTORIZIM

Unë, Notere Mimoza Sadushaj, jam anëtare në degën vendore Tiranë, me seli në Rr "Vaso Pasha" Pll.13/1". Autorizoj Znj.Ina Papa, zëvendësnotere sipas urdhërit me nr. 404, datë 13.06.2023, me të cilën kam lidhur kontratë punë, të kryejë veprimtari noteriale pranë zyrës time, bazuar në nenin 63 pika 2, dhe nenin 66 pika 3, të ligjit "Për Noterinë".

Zëvendësnoterja Ina Papa, ka të drejtë të nënshkruajë akte noteriale, të kryejë veprime noteriale si dhe procedurat e transaksioneve bankare, nga data 11.08.2025 deri në 02.09.2025.

NOTERE
MIMOZA SADUSHAJ

